



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane
Mbledhja nr. 43
Prishtinë, më 05.03.2012, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Blerta Deliu – Kodra, Alma Lama, Blerim Shala dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fatmir Limaj, Vjosa Osmani dhe Suzan Novobërdali.

Me ftesë- Bajram Rexhepi- Ministër i Punëve të Brendshme.

Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Adelina Demolli.

Pjesëmarrës të tjerë: Venera Mjekiqi- Kuvend, Dritero Arifi- MIE.

Mbledhjen e kryesoi, Lutfi Haziri- kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të datës 27. 02. 2012;
3. Raportim i z. Bajram Rexhepi -Ministër i Punëve të Brendshme;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-80 për lojërat e fatit, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L- 94 për shërbimet e shoqërisë informatike, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-97 për bibliotekat në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
8. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet si në vijim.

3. Raportim i z. Bajram Rexhepi -Ministër i Punëve të Brendshme

Kryetari- Tha se pas hartimit të Planit të Veprimit, kemi filluar monitorimin më aktiv ku kemi ftuar disa ministra për raportim, si dhe kemi qenë në monitorim të disa ministrive. Ju kemi ftuar që të raportoni për veprimet që i keni ndërmarrë si Ministri për të përmbushur vërejtjet që kanë dalë nga Raporti i Progresit. Njoftoi se në muajin mars do të hartohet raporti i Komisionit për të arriturat në përmbushjen e Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës. Fjalën ia dha Ministrit.

Bajram Rexhepi- Ministër i Punëve të Brendshme- Tha se Plani i Veprimit është prioritet i të gjitha institucioneve tona, sepse dëshirojmë që në hapat e ardhshëm të dalim sa më mirë. Ne si Ministri, i kemi marrë hapat konkretë, pas leximit të Raportit të Progresit dhe para përgatitjes së Planit të Veprimit. Ministria e Punëve të Brendshme është koordinator e procesit të liberalizimit të vizave. Shtoi se kemi një koordinim shumë të mirë me të gjitha institucionet dhe një koordinim të tillë e kemi pasur edhe më herët, andaj shprehu gatishmërinë që të raportojë në Komision sa herë që është e nevojshme. Pasi që është dorëzuar raporti me shkrim, tha se pres pyetjet dhe komentet nga ana e juaj.

Alma Lama- Pyeti se çfarë veprimesh konkrete janë ndërmarrë për sfidën “*Shtylla e operativës së policisë nuk ka kapacitet për sa i përket planifikimit strategjik dhe aftësive analitike*” dhe për sfidën “*Mjedisi në veri të Kosovës ka mbetur sfidues për polici*”. Shtoi se kontrabanda shumë e shtuar në veri, është duke vazhduar nëpër rrugë dytësor e tretësor, andaj çka është duke ndërmarrë Policia e Kosovës për të ndaluar kontrabandën, pasi që kam informata se kontrabanduesit kalojnë shumë afër shtëpisë suaj?

Bajram Rexhepi- Ministër i Punëve të Brendshme- Sa u përket kapaciteteve të policisë për planifikimet strategjike dhe aftësive analitike si shtet i ri që jemi, nuk pretendojmë se i kemi kapacitetet e plota, por çdoherë jemi në ngritje të tyre. Në kuadër të përgjegjësisë së policisë, tha se janë edhe dy procese si vërejtje nga Raporti i Progresit: inteligjenca e udhëheq policinë dhe policia në komunitet. Në këto fushë ka pasur ngecje, por tash ne i kemi ngritur kapacitetet njerëzore në këtë drejtim dhe tani kjo fushë është si prioritet më i lartë i policisë. E gjithë kjo punë varet edhe nga kush është udhëhequr ky proces. Sa i përket veriut, tha se kjo mbetet ende sfidë shumë e lartë dhe të gjithë e dimë se veprimet tona për veriun koordinohen me faktorin ndërkombëtar, ndërsa policia në pjesën veriore ende është fragjile. Sa i përket policisë atje, dyshojmë se kemi policë me pagë të dyfishtë, andaj së bashku me EULEX-in jemi duke bërë reforma në polici, në mënyrë që t'i largojmë ata për të cilët vërtetohen këto dyshime. Ky është një proces, i cili merr më shumë kohë. Sa i përket gjendjes në veri, ai tha se nuk jemi të kënaqur me gjendjen atje,

mirëpo presim që nga një presion pozitiv nga BE-ja, do të arrihet përmirësimi i gjendjes atje. Kemi parë se në veri veprojnë edhe strukturat e MUP-it dhe dyshojmë se struktura të tilla mund të ketë edhe në polici, andaj pretendojmë ta pastrojmë policinë, që të jetë polici profesionale, pavarësisht nga etniteti. Sa i përket kontrabandës, tha se fillimisht ka qenë zvogëluar maksimalisht në krahësim me vitet e mëparshme, mirëpo kohëve të fundit vërehen lëvizje më të mëdha. Kontrabandistët tentojnë që përmes rrugëve anësore të depërtojnë. Njoftoi se vijën e gjelbër ende e menaxhon KFOR-i, por gjendja nuk është e mirë dhe se janë në koordinim me EULEX-in dhe KFOR-in për të kthyer gjendjen normale. Sa i përket asaj se kontrabanda zhvillohet afër shtëpisë së tij, tha se mund të kalojë kontrabandë e nivelit të ulët . Aty ka task forcë dhe administratë tatimore, ku çdo ditë bën kontrollime dhe konfiskime, mirëpo nuk mund të themi se është mbyllur plotësisht. Ka kontrabandë, por jo në nivelin çfarë po propagandohet apo çfarë ka qenë në të kaluarën. Tha se ne jemi të interesuar që ta minimizojmë krimin ekonomik.

Blerim Shala- Si KFOR-i edhe EULEX-i dokument bazë e kanë Rezolutën 1244 dhe sipas kësaj rezolute, Serbia është e pranishme ilegalisht në veri dhe detyrimet që dalin nga ajo, sa i përket sigurisë, obligojnë KFOR-in, EULEX-in dhe Policinë e Kosovës që të veprojnë në largimin e këtyre strukturave nga veriu. Pyeti: A do të shfrytëzohet Rezoluta 1244 më shumë për t'i kryer detyrimet në veri që dalin nga Rezoluta 1244?

Bajram Rexhepi- Ministër i Punëve të Brendshme- Tha se nuk kam çka të shtoj asgjë nga ajo që tha z. Shala, pra derisa të abrogohet ky dokument, ata janë të obliguar që të veprojnë konform këtij dokumenti. Edhe në kuadër të Rezolutës 1244, për çështjen e integritetit territorial dhe çështjen e sigurisë, dihet se cilët janë mekanizmat e sigurisë dhe janë vetëm tre legalë: KFOR-i, EULEX-i dhe Policia e Kosovës, andaj duhet t'u bëjmë me dije se edhe në kuadër të Rezolutës 1244 i keni këto obligime. Shtoi se çfarëdo veprimi që ne ndërmarrim pa koordinim me ta, ata akuzojnë se nuk po i përfillim. Njoftoi se ka pasur shpesh plane dhe strategji të përbashkëta, por gjithnjë vonimi i implementimit ka qenë për arsye të KFOR-it dhe EULEX-it .Tha se e kemi obligim kushtetues dhe ligjor që të ndërmarrim veprime për veriun dhe vendosjen e lëvizjes së lirë, gjykatës dhe jemi duke ndërmarrë hapa të cilët duken të vegjël, por që do të kenë sukses.

Xhavit Haliti- Pyeti: A ka statistika lidhur me përgatitjen shkollore të policisë, cila është përqindja e policëve me shkollën e vjetër që nuk i janë nënshtruar rikualifikimit dhe cila akademi policore është e vlefshme për Policinë e Kosovës? Paraqiti vërejtje sa i përket organizimit të policisë për çështjet protokollare. Shtoi se policia jonë nuk i përngjan policisë evropiane, por më shumë asaj afrikane sa u përket çështjeve protokollare, sepse përveç ndezjes së dritave, atyre që i prijnë konvojit, nuk kanë asnjë organizim protokollar, qëndrim e as përshëndetje uniforme. Propozoi që të bisedojnë me titullarët e policisë që të krijohet një njësi të përhershme për çështje protokollare. Kërkoj që policia të marrë seriozisht çështjen e mbrojtjes së pyjeve dhe dëmtuesit e pyjeve të trajtohen ashtu siç trajtohen hajdutët. Tha se e kemi Rezolutën 1244, e cila e ndalon veprimin e policisë së Serbisë në Kosovë, mirëpo ka dalë informata se në veri vepron normalisht Polica e Serbisë dhe se e njëjta është e komanduar edhe në enklavat tjera ku ka qytetarë serbë. Pyeti: A ka bashkëpunim Policia e Kosovës me ata të Serbisë, dhe nëse po, në cilat fusha dhe si është forma e komunikimit? Njoftoi se gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Demilitarizimit të UCK-së janë ballafaquar me një presion që në Kosovë të mbesin disa

qindra forca të MUP-it serb. Jam i interesuar të di se a qëndron kjo, pra për sa i përket prezencës së disa qindra forcave serbe në Kosovë, a po mbështeten në Marrëveshjen e Kumanovës dhe a është kjo legjitime që është policia e Serbisë në Kosovë, sipas trajtimit që i bëjnë EULEX-i dhe UNMIK-u kësaj çështjeje?

Alma Lama- Pyeti: Me nënshkrimin e marrëveshjes për fusnotën, çfarë garancish keni marrë nga BE-ja, që do të respektohen ato pjesë të Rezolutës që kanë të bëjnë p.sh. për moszhvillim zgjedhjesh në veri, shuarjen e strukturave paralele, sepse rezoluta nuk parashikon struktura të një shteti tjetër brenda territorit të Kosovës. Kur do të fillojë menaxhimi i integruar i kufirit në bazë të marrëveshjes që keni arritur në Bruksel?

Bajram Rexhepi- Ministër i Punëve të Brendshme - Sa i përket statistikave tha se i kemi këto statistika, mirëpo pasi që kjo nuk është kërkuar nuk i kemi prezantuar. Sa i përket përgatitjes së tyre profesionale, tha se minimumi i përgatitjes së tyre është shkolla e mesme, ndërsa kemi pjesëtarë deri tek doktor shkence. Pas luftës, në vitin 2000, tha se kanë filluar në akademinë policore me trajnime të ndryshme për rifreskim dhe rikualifikim. Sa i përket çështjeve protokollare, ai tha se edhe në kuadër të policisë është njësia e cila bashkëpunon me protokollin shtetëror. Kjo njësi vepron në bazë të kërkesës nga protokollin shtetëror dhe ata angazhohen kryesisht në çështjet e sigurimit të lartë dhe përcjelljes së tyre. Për institucionet vendore tha se janë të rregulluara me akte ligjore çështjet protokollare. Sa i përket çështjes së pyjeve, tha se në bazë të ligjit policia nuk mund të ndërhyjë, andaj janë caktuar rojet e pyjeve. Ne kemi pasur një diskutim nëse rojet duhet të pajisen me armë apo jo. Sa i përket veprimit të MUP-it në veri, tha se nuk është diçka e re dhe të gjitha janë ilegale dhe se nuk kanë të drejtë të ndërmarrin asnjë aktivitet të tillë. Shtoi se Policia e Kosovës nuk ka asnjë kontakt zyrtar me policinë e Serbisë dhe se komunikimi bëhet përmes EULEX-it. Presim që pas fillimit të menaxhimit të integruar të kufirit, komunikimi do të jetë më i madh. Sa i përket Rezolutës 1244, tha se ka qenë një klauzolë në të cilën është thënë se, nëse KFOR-i kërkon ruajtjen e objekteve fetare, atëherë Serbia mund të sjellë një kontingjent për ruajtjen e tyre, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur asnjëherë, andaj edhe këto struktura janë komplet ilegale. Në formë të shkruar nuk kemi asnjë premtim të tillë. Shtoi se po pjekën kushtet në bazë të cilave edhe ata e kane parë që mosorganizimi i zgjedhjeve të injorohet, ndërsa ne do të insistojmë që në asnjë mënyrë të mos mbahen, sepse janë zgjedhje ilegale dhe ne pastaj po i bartim pasojat e zgjedhjeve lokale edhe tani pas disa vitesh. Sa i përket menaxhimit të integruar të kufirit, tha se jemi të gatshëm të fillojmë shumë shpejt, duhet të bëhet vetëm lidhja e IT-së.

Kryetari- Tha se menaxhimi i integruar i kufirit është njëri ndër detyrat kryesore që e keni si Ministri, por problemi është që menaxhimi i integruar i kufirit po ndodh në kohën kur ne nuk kemi njohjen e kufirit. Kufiri i pranuar dhe i përshtetur është ai sipas Marrëveshjes së Kumanovës, është kryesisht kufi ushtarak dhe nuk është ngritur as në bazë të parimit të kufirit të vitit 1974, por është më i ngushtuar. Meqë jemi të hendikepuar pa e parë marrëveshjen dhe për të ditur saktë se çka përmban ajo marrëveshje, pyeti: sa besoni se do të jetë i suksesshëm në realizimin e detyrave dhe a është marrë kjo parasysh apo është lënë e hapur deri në arritjen e marrëveshjes?

Bajram Rexhepi- Ministër i Punëve të Brendshme- Tha se edhe në ligjin e ri janë bërë ndryshime dhe urdhëresat administrative janë duke u hartuar. Njoftoi se demarkacioni me Maqedoninë ka përfunduar, me Shqipërinë tha se nuk kemi pasur ndonjë kontest, sa i përket Malit të Zi tha se parimisht jemi dakorduar që kufiri të jetë ai që ka qenë në vitin '74 dhe se tani është formuar grupi i punës, i cili do të merret me çështjen e demarkacionit me Malin e Zi, ndërsa me Serbinë ende nuk ka një gatishmëri të tillë.

Alma Lama- Pyeti: A mund të kalohet në menaxhim të integruar të kufirit, pa kaluar në procesin e demarkacionit?

Bajram Rexhepi- Ministër i Punëve të Brendshme- Menaxhimi i integruar i kufirit e ka konceptin: policia kufitare, doganierët dhe fitosanitarët ku bëhet vetëm kontrollimi kryesisht i vendkalimeve kufitare dhe për momentin bëhet një lloj delimiimi i tillë, mirëpo ende nuk është kufi shtetëror i demarkuar, por kjo nuk do të jetë pengesë për shkëmbimin e informatave dhe i lëvizjes së lirë.

Alma Lama- Pyeti: A iu besoni ju informatave që vijnë nga Serbia?

Kjo është shumë e rëndësishme. Një shtet i cili çdo moment kërkon ta bojkotojë shtetin e Kosovës mund t'i sjellë informatat jo të sakta.

Bajram Rexhepi- Ministër i Punëve të Brendshme- Tha se sistemi është i njëjtë, mundësia e infiltrimit është shumë e vogël, por nëse ti dyshon, ke mekanizma dhe mjete që të rishikohet saktë. Fillimisht, tha se në gjashtë vendkalime kufitare është paraparë që të vendosen kontejner të përkohshëm. Tre afër pikës ku ne e kontrollojmë dhe tre afër pikës ku kontrollojnë serbët.

Blerta Deliu-Kodra- Tha se gjatë vitit 2011 keni nënshkruar gjashtë marrëveshje për riatdhesim dhe pyeti: A do të vazhdoni të nënshkruani edhe këtë vit marrëveshje të tilla, dhe nëse po, me cilat shtete?

Albert Kinolli- Tha se pasi Ministria e Punëve të Brendshme është koordinatore e procesit të riatdhesimit të personave të kthyer, dua të di si qëndrojnë punët me zyrat komunale për procesin e riatdhesimit dhe sa jeni të kënaqur me punën e këtyre komunave. Po ashtu tha se ka qenë e paraparë që të themelohen edhe katër zyrat në komuna. Çka është bërë deri më tani?

Bajram Rexhepi- Ministër i Punëve të Brendshme- Njoftoi se nënshkrimi i marrëveshjeve për ripranim ka filluar më herët realisht nuk ka qenë obligim që të nënshkruhen marrëveshje me të gjitha shtetet e BE-së, mirëpo është edhe një opsion tjetër që në rast se e përmbyllim nënshkrimin me shumicën e shteteve ku kemi prezencë më të madhe të qytetarëve tanë, atëherë do të lejohet edhe një marrëveshje e përbashkët me Komisionin Evropian ku pastaj nuk do të ketë nevojë që të bëhet marrëveshje me secilin shtet veç e veç. Njoftoi se tani është duke u insistuar që të nënshkruajnë marrëveshje edhe me vendet e treta ku si më e rëndësishmja për ne tha se është Turqia. Sa i përket zyrave komunale për riatdhesimin e personave, tha se me Strategjinë e re, është duke u bërë decentralizimi i fondeve dhe në këtë mënyrë secila komunë e ka fondin e vet për këtë

çështje. Njoftoi se janë katër komuna të cilat arsyetohen se nuk kanë mundësi për të bërë këtë punë.

Kryetari- Falënderoi Ministrin për raportim.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 27. 02. 2012.

Procesverbali i datës 27.02.2012 u miratua pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari - E ftoi deputeten Blerta Deliu-Kodra, referuese e Projektligjit, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Blerta Deliu-Kodra - Pas shqyrtimit, konstatuam se ky Projektligj, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE- së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni me një abstënim e nxori këtë*

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për administratën tatimore dhe procedurat, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL është në harmoni me Acquis Communautaire.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-80 për lojërat e fatit, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari - E ftoi deputetin Albert Kinolli, referues i Projektligjit, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

Albert Kinolli - Pas shqyrtimit, konstatuam se ky Projektligj, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE- së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni me një abstënim e nxori këtë*

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-80 për lojërat e fatit, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL është në harmoni me Acquis Communautaire.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L- 94 për shërbimet e shoqërisë informatike, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetari - Referuesi i Projektligjit, paraqiti raportin për këtë Projektligj.

Kryetari - Pas shqyrtimit, konstatuam se ky projektligj, me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE- së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni me një abstënim e nxori këtë*

Përfundim

Projektligji nr. 04/L- 94 për shërbimet e shoqërisë informatike, me amendamentet e Komisionit Funksional është në harmoni me Acquis Communautaire.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-97 për bibliotekat në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetari - Referuesi i Projektligjit paraqiti raportin për këtë Projektligj.

Kryetari - Pas shqyrtimit, konstatuam se ky Projektligj, me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE- së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni me një abstënim e nxori këtë*

Përfundim

Projektligji nr. 04/L-97 për bibliotekat në Republikën e Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funksional është në harmoni me Acquis Communautaire.

8. Të ndryshme

a) Hartimi i raportit të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë

Kryetari- Kërkoi që të fillohet me e hartimit të raportit për Planin e Veprimit, pasi që pritët që në seancën e fundit të muajit mars, të paraqitet raporti i parë për Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Lutfi Haziri

